

Raporti I **mbi Transparencën në Gjykata**



Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Administrative e Shkallës së Parë, Shkodër

Qershor 2018



Ky raport u përgatit me iniciativën e shoqatës “Intelektualet e rinj, Shprese”, me mbështetjen financiare të Olof Palme International Center përmes financimit të Qeverisë Suedeze dhe Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Shqipëri përmes financimit të Qeverisë Shqiptare. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e autorit dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikpamjet e donatorëve

Përmbajtja

1. Përmbledhje	4
2. Metodologjia	5
3. Gjetjet e këtij monitorimi	
3.1. Gjetjet për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë	6
3.2. Gjetjet për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër	8
4. Përfundimet e këtij monitorimi	11
4.1 Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Shkodër	11
4.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër	12
5. Rekomandime	14
6. Analizë e legjislacionit shqiptar mbi të drejtën e informimit	
6.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë	15
6.2. Ligji 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”	15
6.2.1. Afati	16
6.2.2. Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparences	16
6.2.3. Ankimi administrative dhe Ankimi në gjykatë	19
6.3. Ligji nr. 98/2016 Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë ...	19
7. Rezultatet e Monitorimit për Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Shkodër	
7.1. Faqja zyrtare e internetit	21
7.2. Programi i transparences	23
7.3. Analiza në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”	24
8. Rezultatet e Monitorimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër	
8.1. Komunikimi zyrtar me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër	36
8.2. Programi i transparences	42
8.3. Analiza në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”	43

1. Përmbledhje

E drejta e informimit dhe transparenca përbën një nga elementët thelbësorë që duhet të garantohen për të gjithë qytetarët, nga të gjithë institucionet publike. Transparenca nënkupton ndarjen e informacionit si edhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve në mënyrë të hapur me publikun. Aksesit i lirë ndaj informacionit luan një rol kyç në promovimin e transparencës dhe në parandalimin e korrupsionit dhe si të tillë institucionet publike duhet ta ofrojnë atë në kohë dhe në mënyrë të plotë për qytetarët, me qëllim që të garantojnë një përdorim sa më efektiv të tij.

Ky raport realizohet me iniciativën e shoqatës “Intelektualët e rinj, Shpresë” (IRSH), për të rritur transparencën në gjykata në vazhden e përpjekjeve të kësaj shoqate për të rritur kontributin e saj publik, në forcimin e transparencës dhe të drejtës për informim si një e drejtë themelore e qytetarëve, që duhet të respektohet dhe garantohet nga të gjitha institucionet përfshirë këtu edhe institucionet e drejtësisë.

Qëllimi i këtij raporti është të ndërjegjësoj të gjithë sistemin e drejtësisë në Shqipëri në lidhje me rëndësinë që i duhet kushtuar në praktikë zbatimit të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nga Gjykatat shqiptare. Në fokus të këtij raporti janë Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.

Sipas pikës 1 të nenit 2, të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, është përcaktuar si subjekt i këtij ligji çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj. Pra rezultoi se edhe institucionet të cilat japin drejtësi janë subjekte të këtij ligji prandaj transparenca përbën një detyrim ligjor edhe për këto organe. Duhet theksuar se transparenca është jo vetëm një detyrim ligjor por gatishmëria në dhënie të informacionit nga institucionet e administratës gjyqësore rrit përgjegjshmërinë e tyre në shërbimin ndaj qytetarëve.

Gjykata Administrative Shkodër, për grumbullimin e informacionit zyrtarë, IRSH ka dërguar 14 kërkesa për informim drejtuar Gjykatës Administrative Shkodër ku formalisht është kthyer përgjigje brenda afatit ligjorë por pa u dhënë i plotë informacioni i kërkuar. IRSH ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Komisionerit për të drejtën për informim si dhe pranë Ministrisë së Drejtësisë. Me ndërhyrjen e këtyre institucioneve është bërë i mundur pjesërisht sigurimi i informacionit të kërkuar. Nga këto 14 kërkesa informacioni i plotë është siguruar vetëm për 7 kërkesa për informim, për 5 kërkesa të tjera përgjigja ka qënë e pjesshme, 1 kërkesë i është referuar institucioneve të tjera, ndërsa për 1 kërkesë përgjigja nuk është dhënë në formën e kërkuar të përcaktuar sipas ligjit. Po ashtu faqja zyrtare e internetit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ku informacioni duhet të jepet pa kërkesë, rezultoi që nuk ishte funksionale por si rezultat i presionit institucional të ushtruar në zbatim të ligjit nga ana e organizatës “Intelektualët e rinj, Shpresë” për herë të parë Gjykata Administrative Shkodër filloi të publikonte aktivitetin e saj në faqen zyrtare të internetit <http://www.gjykata.gov.al/gjykata-administrative-shkodër> duke publikuar njëkohësisht një pjesë të madhe të informacionit të detyrueshëm sipas ligjit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për grumbullimin e informacionit zyrtarë janë dërguar 14 kërkesa për informim. Nga të cilat nuk është kthyer asnjë përgjigje brenda afatit ligjor 10-ditore. Me ndërhyrjen e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u bë e mundur marrja e një pjese të informacioneve të kërkuara. Informacioni i dërguar në formë shkresore kryesisht ka qënë i pjesshem ose ka munguar krejtësisht. Problem për të dyja gjykatat mbetet mungesa e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve online.

Për më tepër referohuni në rezultatet e monitorimit më poshtë:

2. Metodologjia

Aktivitetet monitoruese për hartimin e këtij raporti janë realizuar gjatë periudhës **Shtator 2017- Shkurt 2018**. Në realizimin e tij metodologjia kryesore është ajo krahasuese dhe analitike duke analizuar legjislacionin mbi të drejtën e informimit dhe krahasuar zbatimin e tij në praktikë me informacionin e grumbulluar nga aktivitetet monitoruese me fokus Gjykatën Administrative Shkodër dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me qëllim për të ndërtuar një bashkpunim sa më të mirë në funksion të realizimit të këtij raporti monitorues janë bërë 3 kërkesa për takime të drejtpërdrejta me titullaret e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Ministrisë së Drejtësisë, nga të cilat vetem Ministria e Drejtësisë shprehu gatishmerine për tu takuar dhe në kuadër të takimit u bë një prezantim i projektit, menyres së zbatimit dhe rendësisë së tij.

Burimi kryesor i informacionit zyrtarë në lidhje me aktivitetin e këtyre gjykatave është siguruar nëpërmjet kërkesave për informim të adresuara në rrugë zyrtare drejt Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Përmbajtja e këtyre kërkesave për informim është bazuar në 28 kriteret e ligjit 119/2014 “**Për të drejtën e informimit**” të përcaktuara në nenin 7 të tij tek kategoritë e informacionit që duhet bëhen publik pa kërkesë. Gjithsej janë dërguar nga shoqata “Intelektualët e rinj, Shpresë” (IRSH), 14 kërkesa për informim për secilën gjykatë.

Për sigurimin e informacioneve nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër janë ndjekur rruget e ankimit administrative prane institucionit të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ku janë depozituar 4 ankime, të cilat janë pranuar nga ky institucion.

Për nevojat e këtij raporti janë monitoruar faqet zyrtare të internetit të Gjykatës Administrative Shkodër <http://www.gjykata.gov.al/gjykata-administrative-shkodër/gjykata-administrative-shkodër/> dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër <http://www.gjykata.gov.al/rrethi-shkodër/gjykata-e-rrethit-shkodër/>. Nga ku është vëzhguar nese janë vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre të internetit kategoritë e informacionit të kërkuara sipas ligjit. Dhe është vëzhguar ecuria e të dy gjykatave në përditesimin e faqes së internetit që administrohet prej tyre.

Janë realizuar vëzhgime në ambjentet e gjykatave, për të vlerësuar kategoritë e informacionit të publikuara, pranë ambienteve të tyre, pa kërkesë.

3. Gjetjet e këtij monitorimi

3.1. Gjetjet për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë

Në bazë të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” çdo autoritet shtetëror duhet të ketë **faqen e internetit** ku duhet të publikojë një sërë informacionesh. Janë 28 kriteret të përcaktuar në këtë ligj që duhet të publikohen.

Gjykata administrative Shkodër nuk kishte të plotësuar asnjë kriter dhe faqja zyrtare e internetit ishte jashtë funksionit. Nepermjet një bashkpunimi pozitiv me drejtuesit e kësaj gjykate është reflektuar pozitivisht ndaj kërkesave të adresuara në kuader të përgatitjes së këtij raporti dhe aktualisht rezulton se janë plotësuar 12 nga 28 kriteret që përcakton ligji, ose e shprehur në përqindje 42% e tyre. Mëposhtë në mënyrë të përmbledhur prezantojmë përmbushjen e kriterëve ligjore nga ana e Gjykatës Administrative të shkallës së parë Shkodër:

- 1. Faqja zyrtare e interneti** e Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë nuk ishte funksionale. Nepermjet kërkesave për informim dhe ndjekjes zyrtare të këtij problem në autoritetet publike, të cilët kanë nekompetence administrimin e gjyqësorit u arrit të bëhej funksionale faqja zyrtare e internetit të kësaj gjykate.
- 2. Programi i transparencës** për Gjykatën Administrative të Shkallës Parë nuk ishte i publikuar ne faqen zyrtare të internetit por ky informacion gjendet tashme në faqen zyrtare.
- 3. Rregullorja e brendshme e funksionimit** nuk ishte e publikuar dhe tashme Gjykata Administrative Shkodër e ka të publikuar në faqen zyrtare të internetit rregulloren e brendshme për funksionimin e këtij institucioni.
- 4. Struktura e gjykatës** nuk ishte e publikuar në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Shkodër, tashme kjo gjykatë ka të publikuar organogramen dhe emrat e gjyqtareve të kësaj gjykate.
- 5. Vendndodhja e zyrave të autoritetit publik, orari i punës, emri dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit** këto informacione nuk ishin të publikuara nga Gjykata Administrative Shkodër, tashme gjenden online.
- 6. Informacionet në lidhje me 1. arsimin, kualifikimet e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë 2. pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, 3. strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, 4. një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, 5. kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurat që ata ndjekin për të marrë vendime.**

Gjykata e Administrative e Shkallës së parë ka plotësuar 2 nga këto kriteret konkretisht informacion për nivelin e arsimit të punonjësve dhe pagat për funksionarët, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, këto informacione janë siguruar në formë shkresore ndërsa në faqen zyrtare të internetit nuk janë të publikuara.

- 7. Informacion mbi mekanizmat monitorues dhe të kontrollit** që veprojnë mbi gjykatat, përfshirë **planet strategjike të punës, raporte të auditimit** nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe **dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit**;
Në faqen zyrtare të internetit nuk ka të publikuar asnjë nga këto informacione. Në rrugë zyrtare Gjykata Administrative ka dërguar një kopje të projekt raportit të angazhimit të auditimit të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe është shprehur që nuk ka qënë asnjeherë subjekt i auditimit nga KLD-ja.
- 8. Informacione për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara**, si dhe çdo **raport vjetor për zbatimin e buxhetit**.
Gjykata Administrative Shkodër ka plotësuar pjesërisht këtë kërkesë të ligjit, dhe ka dërguar në formë shkresore, të dhëna në lidhje me detajimin e fondit për Gjykatën Administrative Shkodër, në investime për vitin 2017, të dhëna në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore dhe me mallrat e shërbimet dhe dokumente në lidhje me aktivin dhe pasivin e bilancit kontabël 2016 dhe gjithashtu pasqyrën e lëvizjes në CASH të vitit 2016. Nuk ka të publikuar buxhetin dhe raportet vjetore për zbatimin e tij.
- 9. Informacionet mbi procedurat e prokurimit apo ato konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat**, nga informacioni i dërguar në formë shkresore jepen të dhëna të pjeshme.
Gjykata Administrative Shkodër në formë shkresore ka dërguar informacion për komisionin për blerje të vogla, i cili është i përbërë nga tre anëtar, por nuk jepet asnjë informacion në lidhje me emrat e tyre, gjithashtu në faqen zyrtare të internetit nuk pasqyrohet asnjë informacion i tillë;
- 10. Informacion mbi shërbimet që autoriteti publik i jep publikut**, përfshirë **standardet për cilësinë e shërbimit**. Gjatë vëzhgimit të faqes zyrtare të internetit të Gjykatës Administrative Shkodër rezulton se nga përditësimi i saj është siguruar informacion mbi shërbimet dhe tarifave të tyre por mungojnë të dhëna mbi standartet dhe cilësinë e shërbimeve.
- 11. Informacione mbi çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave**, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik.
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka sjellë informacion për menyrën se si bëhen kërkesat dhe ankimet pranë kësaj gjykate, kurse në faqen zyrtare të internetit nuk ka informacione të publikuara.
- 12. Informacionet mbi çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre**. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka një hapësirë në faqen zyrtare të internetit ku personat e interesuar mund të japin mendimet ose sugjerimet e tyre.
- 13. Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë**. Gjykata Administrative të Shkallës së Parë ka informacion mbi sistemin që përdorin për të ruajtur dokumentet dhe ka të publikuar kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë në programin e transparencës.

14. **Publikim i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve** në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative Shkodër, ky detyrim ligjor rezultoi i pazbatuar.
15. **Informacione mbi kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore**, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të **procedurave për t'i përfituar**. Në faqen zyrtare nuk ka informacion të publikuar se çfare ndihme shoqërore apo ndihmë juridike ofrohet për grupe të caktuara shoqërore.
16. **Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh**. Në faqen zyrtare te internetit të gjykatës nuk ka asnjë informacion në lidhje me ato dokumenta të cilat kërkohen më shpesh dhe as nga komunikimet zyrtare një informacion i tillë nuk disponohet.
17. **Çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm** nga autoriteti publik, ka një sërë informacionesh që gjenden në faqen zyrtare të internetit.

3.2. Gjetjet për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në faqen e internetit kishte të plotësuar vetem 4 kritere nga 28 që përcaktonte ligji, në përfundim të këtij monitorimi kjo gjykatë ka të plotësuar 11 kritere ligjore. Në përqindje përllorarit se nga 14% e kritereve që kishte të plotësuar, tashme Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka plotësuar 39% të kritereve të përcaktuara nga ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Mëposhtë në mënyrë të përmbledhur prezantojmë përmbushjen e kritereve ligjore nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër:

1. **Faqja Zyrtare internetit**. Gjatë aktiviteteve monitoruese në lidhje me zbatimin e kritereve ligjore nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër rezultoi se faqja zyrtare online ishte funksionale por informacioni ishte i papërditësuar. Pas komunikimeve të vazhdueshme me autoritetet e gjykatës u publikuan informacione të detyrueshme sipas ligjit.
2. **Programi i transparencës** për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër ishte i publikuar. Gjatë periudhës së zhvillimit të aktiviteteve të monitorimit kjo faqe është strukturuar në mënyrë më të qartë dhe lehtësisht të aksesueshme për publikun duke përcaktuar më mirë rubrikat sipas të cilave gjendet informacioni i kërkuar sipas ligjit.
3. **Rregullorja e brendshme** e funksionimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër rezultoi se nuk ishte e publikuar në faqen zyrtare të saj. Aktualisht ndodhet e publikuar online vetëm një “Rregullore për marëdhëniet e gjykatës me publikun”.
4. **Struktura e Gjykatës** së Rrethit Gjyqësor Shkodër është publikuar me datë 09.10.2017 në faqen e saj zyrtare në dokumentin “Struktura dhe organika e përditësuar”. Kjo gjykatë ka të publikuar emrat e gjyqtareve, por ajo që vihet re është se lista ka nevojë të rifreskohet duke qenë se gjenden akoma emra gjyqtarësh që nuk ushtrojnë më funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
Në faqen zyrtare të Gjykatës jepet informacion mbi **funksionet** që kryejnë punonjësit të përfshirë në organikë, ndërsa për **detyrat** e autoritetit publik nuk jepet informacion.
5. **Vendndodhja e zyrave të autoritetit publik, orari i punës, emri dhe kontaktet e koordinorit për të drejtën e informimit**. Këto informacione gjendeshin pjesërisht të

publikuara duke qenë se mungonte emri dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit. Gjatë komunikimeve zyrtare me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër u reflektua pozitivisht duke publikuar emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.

- 6. Informacionet në lidhje me, 1. arsimin, kualifikimet 2. pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, 3. strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe 4. një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, 5. kompetencave 6. detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik 7. procedurat që ata ndjekin për të marrë vendime.**

Nga monitorimi rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka përmbushur vetëm dy prej kritereve të mësipërme duke dhënë informacion vetëm për nivelin e arsimit për punonjësit sipas organikës së kësaj gjykatë si dhe strukturën e pagave për nëpunësit e tjerë.

- 7. Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi gjykatat, përfshirë planet strategjike të punës, raporte të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;**

Nga monitorimi rezulton se në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka publikuar asnjë nga këto informacione dhe as në forme shkresore nuk është siguruar një informacion i tillë!

- 8. Informacione për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.**

Nga monitorimi rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka të publikuar pjesërisht këto informacione online në faqen e internetit, konkretisht gjendet “Detajimi i planit sipas artikujve dhe elementëve përbërës për fondet buxhetore për vitin 2017”, por nuk paraqiten raporte vjetore për zbatimin e buxhetit të viteve paraardhëse.

- 9. Informacione mbi procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, gjenden të dhëna të pjesshme.**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka të publikuar në faqen zyrtare online dokumentin “Regjistër i Realizimit të prokurimeve Publike për periudhën Janar-Gusht 2017” ku paraqitet objekti i prokurimit, fondi limit, shuma e kontraktuar, lloji i procedurës së prokurimit, koha e zhvillimit të procedurës dhe palët kontraktuese, por nuk jepet informacion mbi zbatimin ose monitorimin e këtyre kontratave.

Në lidhje me anëtarët e Njësisë së Prokurimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka asnjë informacion.

- 10. Informacione mbi shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit.** Nga monitorimi rezultoi se nga përditësimi i faqeve është ofruar informacion mbi shërbimet dhe tarifën e tyre por mungojnë të dhëna mbi standartet dhe cilësinë e shërbimeve.

- 11. Informacione mbi çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik.**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka vënë në dispozicion një informacion të tillë në forme shkresore dhe as në faqen zyrtare të internetit nuk ka të publikuara këto informacione.

- 12. Informacione mbi çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre.** Nga monitorimi rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka një hapësirë në faqen zyrtare ku personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre.
- 13. Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë.** Nga monitorimi rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka informacion mbi sistemin që përdor për të ruajtur dokumentet, dhe gjithashtu ka të publikuar kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë në Programin e Transparencës.
- 14. Publikim i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve** në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga monitorimi rezulton se rubrika ekziston, si dhe ka një faqe boshe të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve por detyrimi ligjor nuk mund të konsiderohet i përmbushur.
- 15. Informacione mbi kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore,** subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të **procedurave për t'i përfituar.** Nga monitorimi rezulton se një informacion i tillë në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit gjyqësorë Shkodër nuk është i publikuar. Sipas informacionit të dhënë në rrugë zyrtare nëpërmjet kërkesave për informim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka evidentuar në mënyrë të përgjithshme kategoritë e personave që përjashtohen nga taksat gjyqësore ndërsa për procedurat për të përfituar nga këto ndihma nuk jepet informacion.
- 16. Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.** Nga monitorimi rezulton se në faqen online të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka asnjë informacion të tillë, dhe as nga komunikimet zyrtare një informacion i tillë nuk disponohet.
- 17. Çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm** nga autoriteti publik. Nga monitorimi rezulton se në faqen zyrtare janë publikuar informacione të tilla si “udhëzim”, “tarifa gjyqësore“, “regjistri i permbauesve privat”, “regjistri i ndermjetësve” etj.

4. Përfundimet e këtij monitorimi

Si përfundim rezulton se dy nga gjykatat kryesore në qytetin e Shkodrës nuk e zbatojnë në mënyrën e duhur ligjin 119\2014, "Për të drejtën e informimit". Rritja e nivelit të transparencës dhe garantimi i të drejtës për informim për qytetaret në lidhje me aktivitetin e këtyre gjykatave duhet që të mbetet një detyrë parësore për autoritetet të cilat merren me administrimin e tyre. Vlerësojmë reagimin pozitiv të drejtuesve të këtyre gjykatave të cilët pertej ngarkesës së punës së tyre të përditshme, vetëm gjatë periudhës brenda së cilës kemi zhvilluar aktivitetin monitorues kanë shënuar një përmirësim të dukshëm të informacioneve të cilat jepen në faqen zyrtare të internetit. Aktualisht Gjykata Administrative e Shkallës së parë ka plotësuar 42% të kriterëve të ligjit ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka plotësuar 39% të kriterëve të ligjit 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

4.1 Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Shkodër

- a) Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, nga 14 kërkesa për informim të dërguara në total, 7 kërkesa për informim kanë marrë përgjigje të plotë, për 5 kërkesa përgjigja ka qënë e pjesshme, në 1 rast kërkesa është referuar institucioneve të tjera, ndërsa për 1 kërkesë përgjigjia nuk është dhënë në formën e kërkuar nga ligji.
- b) Gjykata Administrative e Shkallës së parë Shkodër për 9 kërkesat e para për informim të dërguara nga IRSH, e respektoi afatin ligjor prej 10 ditësh për kthimin e përgjigjes, por përmbajtja e shkresës nuk kishte informacionin e kërkuar duke na referuar për marrjen e informacioneve në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative e cila nuk ishte funksionale.
- c) Në funksion të garantimit të së drejtës për informim i jemi drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Duke vlerësuar kërkesën tonë të drejtë dhe të bazuar në ligj Komisioneri për të drejtën e informimit nëpërmjet shkresës nr 1256/1 prot, datë 22.09.2017 urdhëroi Gjykatën Administrative të Shkallës Parë Shkodër që të trajtoj kërkesat për informim të adresuara nga IRSH brenda afatit të caktuar ligjore. Në vijim komunikimi formal dhe informal me Gjykatën Administrative ka qënë brenda afateve të përcaktuara ligjore.
- d) Vlen të përmendet se, nëpërmjet shkresave zyrtare, siç është pasqyruar edhe në raport, është siguruar pjesa më e madhe e informacionit të kërkuar ose shprehur në përqindje vetëm 58% e tij.
- e) Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër ka përmirësim të dukshëm dhe aktualisht 42% e informacioneve që duhet t'i ofrohen publikut pa kërkesë janë të pasqyruara. Kjo gjykatë tashme ka të publikuar programin e transparencës, adresën, emrin dhe menyrat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, organiken, kalendarin e seancave, rregulloren etj.

4.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

- a) Të gjitha përgjigjet, ndaj kërkesave për informim, nuk kanë respektuar afatin ligjor prej 10 ditësh pune të përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”.
- b) IRSH ka ushtruar të drejtën e saj duke ju drejtuar me ankim Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pavarësisht ndërhyrjes së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me 3 shkresa zyrtare, drejtuar Gjykates së Rrethit Gjyqësor, duke vendosur afate konkrete për kthimin e përgjigjeve zyrtare, këto afate janë respektuar vetëm në një rast.
- c) Në përgjigje të 14 kërkesave për informim, kjo gjykatë ka dërguar 8 shkresa në adrese të IRSH-së. Me anë të shkresës 845, datë 11.09.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër është përpjekur të jap informacion për 9 kërkesat e dërguara nga IRSH. Në këtë shkresë Gjykata thekson se informacioni i kërkuar nga IRSH gjëndet në faqen e saj zyrtare, por nga vëzhgimi rezultoj se informacionet mungonin.
- d) Me shkresen 1062 Prot, datë 17.10.2017, drejtuesi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i tërheq vëmendjen IRSH për numrin e lartë të kërkesave për informim duke theksuar faktin se për çdo kërkesë për informim në radhe të parë duhet që të paguhet tarifa. Për të marrë informacion në lidhje me tarifat që ka kjo gjykatë për kërkesat për informim Ju drejtuam Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me anë të kërkesës për informim datë 01.11.2017, me objekt “Kopje të listes së tarifave për riprodhimin dhe dërgimin e informacioneve”. Në mungesë të përgjigjes brenda afateve ligjore IRSH ushtroi të drejtën e ankimit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale. Komisioneri për të drejtën e informimit vlerësoi të drejtë ankimin dhe urdheroi Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër të plotësoj me informacion kërkesën e IRSH. Megjithatë ndërhyrjen e Komisionerit për të drejtën e informimit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk plotësoi kërkesën për informim të drejtuar nga IRSH për të dhënë “Kopje të listes së tarifave për riprodhimin dhe dërgimin e informacioneve” por dërgoi informacion në lidhje me “Tarifat për veprime dhe shërbime që kryhen nga Administrata Gjyqësore, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria dhe Noteria”.
- e) Me shkresen 1112 Prot, datë 06.11.2017, u dërgua informacioni për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit. Me shkresat 1069 Prot, 1070 Prot, 1071 Prot, 1072 prot, datë 27.10.2017, por të dërguara me anë të postes në datë 23.11.2017, janë dërguar informacione për kërkesat për informim numer 11, 12, datë 20.10.2017 dhe 13 dhe 14 datë 23.10.2017. Nga të cilat u siguruan informacione të pjeshme. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër pasqyruar në përqindje rezultoi se ka kthyer përgjigje zyrtare, duke dërguar informacionin e kërkuar në masën 33%.
- f) Referuar vendimeve të publikuara në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë viteve 2016-2017 rezultoi se Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Shkodër ka qënë subjekt i ankimit për refuzim për të dhëne informacionin, në bazë të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ndaj të cilës Komisioneri për të drejtën e informimit ka dhënë në total 3 vendime. Si përfundim rekombandojme që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër të vlerësoj me prioritet zbatimin e kërkesave të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit” duke respektuar në mënyrë të veçantë afatet ligjore për dhënien e informacionit të kërkuar.

- g) Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër pavarësisht komunikimit zyrtarë gjatë periudhës së monitorimit ka pasur ecuri pozitive. Faqja zyrtare e Gjykatës së rrethit gjyqësorë Shkodër gjatë periudhës brenda së cilës kemi zhvilluar aktivitetin monitorues është përditsuar me informacione dhe publikime të reja. Gjykata tashmë ka të publikuar: programin e transparences, adresen, emrin dhe menytrat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit etj.
- h) Konkretisht me datën 09 Tetor 2017 në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër rezulton se janë bërë përditesime ku janë publikuar rreth 8 informacione shtesë.

5. Rekomandime

Në përfundim të këtij monitorimi rekomandojme:

- a) Faqja zyrtare e Gjykatave duhet që të përditësohet në mënyre korrekte me informacionet të cilat i shërbejnë qytetareve. Kjo formë do të lehtësonte njëkohësisht punën e gjykatës me qytetaret duke i adresuar ato drejt informacionit online dhe nga ana tjetër qytetaret do të kursenin kohën e tyre.
- b) Gjykatat duhet që të vlerësojnë respektimin e procedurave dhe afateve ligjore për kthimin e përgjigjeve dhe adresimin e kërkesave/ankesave për të garantuar të drejtën e informimit duke dhënë informacionin e kërkuar brenda afatit ligjor.
- c) Faqja zyrtare e internetit të Gjykatave duhet që të jetë e strukturuar mirë në mënyre që qytetaret të orientohen lehtësisht në gjetjen e atyre informacioneve për të cilat janë të interesuar.
- d) Rekomandohet të krijohet në faqen zyrtare të gjykatave, një rubrike dedikuar legjislacionit që është në fuqi për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor dhe gjithë paketës ligjore që gjykatat kanë detyrim për të zbatuar gjatë veprimtarisë së tyre. Bie në sy mungesa totale e ligjeve në website të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, ndërsa në website të Gjykatës Administrative mungojnë ligje të tilla si: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, paketa ligjore për reformën në gjyqësor, apo edhe ligji 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” etj.
- e) Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve duhet që të publikohet dhe të rifreskohet në mënyre periodike sipas detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 8 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- f) Faqja zyrtare e Gjykatave duhet të publikoj mënyrat se si bëhen kërkesat për informim nga qytetaret dhe afatet ligjore që duhet të trajtohen këto kërkesa nga institucioni përkatës.
- g) Gjykata Administrative dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër duhet të publikojnë të dhëna të plota, për strukturën organizative të secilës gjykatë, arsimimin, për pagat e funksionarëve të cilët kanë detyrimin për deklaram të pasurisë sipas ligjit dhe strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, procedurat e zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të këtij autoriteti publik, procedurat për marrjen e vendimeve.
- h) Vlerësojme shumë me rendesi prandaj edhe rekomandojme publikimin e informacionit për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara. Po ashtu rekomandojmë publikimin e raporteve vjetore të zbatimit e buxhetit, raporteve të auditimit etj. Tregues të tillë rrisin nivelin e transparencës në zbatimin e buxhetit nga gjykatat;
- i) Rekomandojme Gjykatës Administrative Shkodër që në mënyre të përsëritur, të kërkojë plotësimin e organikes me gjyqtare të tjerë, duke qenë se konstatohet lehtësisht se mbingarkesa e çështjeve për gjyqtarët dhe të tejkalimi i afateve për gjykimin e çështjeve është bërë një problem shqetësues për qytetaret të cilët në mënyre të përsëritur e kanë shprehur gjatë përgatitjes së këtij raporti.

6. Analizë e legjislacionit shqiptar mbi të drejtën e informimit

6.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 23 parashikon se e drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.

Po ashtu neni 48 i Kushtetutës parashikon se kushdo, vetë ose bashkë me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj. Kushtetuta jonë ka ndjekur të njëjtën linjë me aktet ndërkombetare në fushën e të drejtave themelore të njeriut dhe si rrjedhojë edhe për të drejtën e informimit.

Bazat e të drejtës së informimit, si një e drejtë themelore që e gëzojnë të gjithë pa dallim, janë hedhur në nivel ndërkombëtar përmes Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut në nenin 19 të së cilës sanksionohet liria e opinionit dhe shprehjes si edhe e drejta për të "kërkuar, marrë dhe shpërndarë informacion", që përsëritet në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Politike dhe Civile.¹ Më tej, një Rekomandim i Komisionit për të Drejtat e Njeriut në OKB, që daton në 2011, në lidhje me nenin 19 të Deklaratës Universale specifikon të drejtën e aksesit në informacion sikundër nënkuptohet nga neni në fjalë dhe thekson domosdoshmërinë e bërjes efektive të ligjit përmes masave të ndryshme. Këto përfshijnë përgatitjen e kuadrit ligjor dhe angazhimin aktiv të institucioneve publike për të vendosur në hapësirën publike informacione me interes publik.²

6.2. Ligji 119\2014, "Për të Drejtën e Informimit"

Mbi bazën e Kushtetutës, Ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", rregullon në mënyrë të hollësishme të drejtën e informimit dhe realizimin e saj në praktikë, duke përcaktuar edhe detyrimet që burojnë nga ligji për organet publike, si dhe afatet e procedurat që duhet të respektohen në realizimin e kësaj të drejte. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. Nga ana e tij, Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

¹ http://www.right2info.org/resources/publications/instruments-and-standards/un_udhr_eng

² <file:///C:/Users/PC/Downloads/UNHRCgeneral-comment34%20on%20Article19.pdf>

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji. Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre. Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit:

një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta; një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.

Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:

-emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;

-adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;

-përshkrimin e informacionit që kërkohet;

-formatin në të cilin preferohet informacioni;

-çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.

Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

6.2.1. Afati

Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.

Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim. Refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë.

6.2.2. Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës

Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.

Në përgatitjen e programit të transparencës, autoriteti publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) *garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;*
- b) *vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;*
- c) *modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.*

Në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;
- b) tekstet e plota:
 - i. *të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;*
 - ii. *të ligjeve;*
 - iii. *të akteve nënligjore;*
 - iv. *të kodeve të sjelljes;*
 - v. *të çdo dokumenti politikash;*
 - vi. *të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;*
- c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- ç) të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej

tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;

ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:

- i. listën e kontratave të lidhura;*
- ii. shumën e kontraktuar;*
- iii. palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;*
- iv. informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;*

a) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

b) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;

j) një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t’i përfituar ato;

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

Autoriteti publik, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike.

Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe

publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.

Mosvënia në zbatim e programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, konsiderohet kundravajtje administrative dhe dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë; po ashtu mosrishikimi i programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 5, të këtij ligji, dënohet me 50000 deri në 100 000 lekë;

Për zbatimin e këtij ligji, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik, cakton një prej punonjësve si koordinator për të drejtën e informimit.

6.2.3. Ankimi administrative dhe Ankimi në gjykatë

Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me marrjen e një ankese, i kërkon ankuesit dhe organit publik kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditësh. Kur e sheh të përshtatshme Komisioneri organizon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

Komisioneri kur arrin në përfundimin që ka shkelje të dispozitave të këtij ligji, i propozon organit publik përgjegjës marrjen e masave administrative ndaj personit/personave përgjegjës, sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi.

Ankimi në gjykatë

Kërkuesi ose autoriteti publik ka të drejtë ta ankimojë vendimin e komisionerit në gjykatën administrative kompetente.

6.3. Ligji nr. 98/2016 Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e gjykatave të të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë. Në nenin 46 të tij parashikon marrëdhëniet me publikun dhe në pikën 1\ç) dhe pikën 2 të këtij neni citohet:

“ Shërbimet për marrëdhëniet me publikun kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që:

ç) të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”, në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore”;

“ Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë”;

Koordinatori për të drejtën e informimit është i parashikuar gjithashtu në nenin 46, pika 4 dhe 5 të këtij ligji:

4. Këshilli i Gjykatës cakton nëpunësin civil gjyqësor për marrëdhëniet me publikun si koordinator, në përputhje me ligjin për kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit.

5. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun ushtrohen nga ose nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun

Ndërsa neni 47 parashikon shërbimin e teknologjisë së informacionit:

Shërbimet e teknologjisë së informacionit sigurojnë:

- a) mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave në gjykatë, të mbajtura në formë elektronike nëpërmjet sistemeve kompjuterike, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;
- b) ruajtjen e rregullt të statistikave të gjykatës.

7. Rezultatet e Monitorimit për Gjykatën Administrative Shkodër

7.1 Faqja zyrtare e internetit

Në bazë të nenit 7, pika 1 e ligjit 119\2014, “Për të Drejten e Informimit”, “*në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet informacionet....*”

Sipas nenit 14, pika 1 e ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, “*Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet*”.

Nga monitorimi u konstatua se faqja zyrtare e internetit të kësaj gjykate nuk funksiononte, ky fakt konfirmohet edhe nga shkresa e Gjykatës Administrative Shkoder, drejtuar IRSH-së, me nr. 760\9 Prot datë, 08 09 2017, ku është cituar: “... gjithçka kërkohet është informacion i cili sipas nenit 7 të ligjit 119\2014, aksesohet në faqën e internetit **që duhet të kishte gjykata jonë, pra jo domosdoshmërisht me kërkesë.**”

Fig.1. Shkresa dërguar nga Gjykata Administrative Shkodër, nr. 760\9 Prot datë, 08 09 2017.

Në përmbushje të kërkesave të prezantuara nga subjekti juaj, për marrje informacioni pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkoder, për ato çfarë bëhen presente nga ana juaj, sqarojmë se, gjithçka kërkohet është informacion i cili, sipas nenit 7 të ligjit 119/2014, aksesohet në faqen e internetit që duhet të kishte Gjykata jonë, pra jo domosdoshmërisht me kërkesë. Duke qënë se, deri më tani, institucionet kompetente për të krijuar dhe më pas për të bërë funksionale, faqen zyrtare të të gjitha Gjykatave Administrative të Shkallave të Para në RSH, nuk kanë mundur të aksesojnë një akses të tillë (me gjithë interesimin e vazhdueshëm të shprehur nga ne si gjykatë), mbetet që i gjithë seti i këtij informacioni, lehtësisht do të jetë i aksesueshëm në një të ardhme sa më të shpejtë. Por, ju bëjmë me dije njëkohësisht, se për shumë nga informacionet për të cilat shprehni interes t'i kenë, aktualisht mund t'i dispononi duke ju drejtuar institucioneve qendrore përkatëse që rregullojnë dhe menaxhojnë funksionimin dhe administrimin e gjyqësorit.

Duke ju vlerësuar për iniciativat e reja që ndërmerrni, ju urojmë punë të mbarë!

**KRYETARE**
Valbona DURRAJ

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër nuk vendosi në dispozicion informacionet e kërkuara as në formë shkresore dhe as në website, duke qënë se nuk dispononte faqe zyrtare interneti. Kështu me date 19. 09. 2017 shoqata “Intelektualet e rinj, Shprese” (IRSH), depozitoj pranë Komisionerit për të

Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, një ankim kundër Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Pas shqyrtimit të ankimit Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me shkresën nr 1256\1 Prot, datë 22. 09. 2017, i kërkoj Gjykatës administrative të shkallës së parë Shkodër të trajtojë kërkesat për informacion të dërguara nga IRSH-ja brenda një afati përcaktuar.

Fig. 2. Shkresa nr 1256\1 Prot, datë 22. 09. 2017 e Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është depozituar ankesa nr. 1256 Prot., datë 19.09.2017, nga Z. Saimir Beqiraga, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*, ndaj Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër (në vijim Autoriteti Publik).

Ankuesi nëpërmjet kërkesave së datave 28.08.2017, 29.08.2017, 30.08.2017, 31.08.2017 dhe 04.09.2017, 05.09.2017, 06.09.2017, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me:

Fig. 3. Pjesa urdheruese e vendimit të Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me shkresën nr 1256\1 Prot, datë 22. 09. 2017.

Për sa më sipër, përpara marrjes së vendimit, Komisioneri kërkon të trajtoni kërkesën dhe të vlerësoni dhënien e informacionit të kërkuar brenda datës 28.09.2017. Në rast mosveprimi nga ana juaj brenda afatit të përcaktuar (datë 28.09.2017), Zyra e Komisionerit do të vlerësojë mbi ndjekjen e procedurës së mëtejshme në përputhje me nenin 18 dhe 24 të ligjit nr. 119/2014.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



Menjehere pas kësaj ndërhyrjeje nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, u bë i aksesueshem website i Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Shkodër dhe nisi monitorimi i informacionit që kjo gjykatë kishte në dispozicion të publikut.

Fig.4. Faqja e internetit e Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Shkodër;



7.2. Programi i transparencës

Në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 4/1 i këtij ligji përcakton se: *“Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.”*

Nga monitorimi, Gjykata Administrative Shkodër në kundërshtim me ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” nuk kishte të miratuar dhe publikuar “Programin e Transparencës”. Pas kërkesave për informacion të dërguara, u reflektua nga ana e këtij institucioni dhe nisi përditësimi i Faqes zyrtare te internetit të kësaj gjykate.

Fig. 5. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Programi i transparences, marre datë 08.09.2017



Fig. 6. Programi i transparencës u publikua nga Gjykata me datë 26. 10. 2017



7.3. Analiza në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Nga analiza e kritereve të parashikuara nga neni 7 i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, informacioneve nepermjet përgjigjeve zyrtare me Gjykatën Administrative dhe monitorimit të website të kësaj gjykatë kanë dalë këto të dhëna:

Sipas nenit 7, pika 1, germa a) të ligjit përcaktohet se: *“autoritetet publike duhet të vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;*

Fig. 7. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Struktura e gjykatës, si ishte:



Fig. 8. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Gjykatësit


The screenshot shows the official website of the Administrative Court of Shkodër. The header includes the court's name in Albanian and English, along with navigation links and a search bar. The main content area features a search form with fields for 'Emri' (Name), 'Nga data' (From date), and 'Deri në datën' (Until date), and a 'Kërko' (Search) button. Below the search form is a table listing judges with their names and the date they started their work.

Emri	Data e fillimit të punës	
Valbona Durraj	04-05-2015	Shfaq çështjet
Ahmet Jangulli	04-05-2015	Shfaq çështjet

Nga perditesimi i informacionit në faqen zyrtare te internetit të gjykatës u publikua organograma e kësaj gjykate.

Ky informacion u sigurua edhe me shkresen nr. SH-239/1 Prot, datë 09.10.2017 të Ministrisë së Drejtësisë, ku specifikohet “Struktura dhe Organika e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër” për vitin 2017.

Fig.9. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Struktura e gjykatës, si është;



Në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative Shkodër rezulton të jetë e publikuar organograma, emrat e dy gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe data e fillimit të punës së tyre në këtë gjykatë. Së dyti, sipas dekretit të Presidentit nr.7818 datë 16.11.2012 numri i gjyqtarëve në Gjykatën Administrative Shkodër duhet të jetë 4, por aktualisht është 2. Këtë çështje të vakancës e ka ngritur edhe OSCE në raportin e saj mbi monitorimin e gjykatave administrative³, por gjendja vazhdon të mbetet e njejte. Kjo çon edhe në mbingarkesë të çështjeve për gjyqtarët dhe në tejkalim afatesh gjykimi për çështjet.

Në lidhje me percaktimet e nenit 7, pika 1 gërma b, të ligjit ku duhet të jepet informacion për ligjet dhe aktet nënligjore në mbështetje të të cilave gjykata operon, kodit të sjelljes, rregullores së brendshme të gjykatës ose çdo dokumenti politikash ose me interes publik të gjërë;

Pas kërkesës për informim nr 1, datë 28. 08. 2017 me objekt: “ Kopje të Rregullores së brendshme të Gjykatës Administrative Shkodër”;

Gjykata Adminstrative Shkodër ka dërguar një kopje të Rregullores së brendshme të këtij institucioni ku përshkruhen edhe funksionet dhe detyrat e këtij Autoriteti Publik si p.sh: funksionet e Kryetarit të Gjykatës, detyrat e gjyqtarëve, të kancelarit, të sekretarisë gjyqësore, punonjësit të IT etj.

Ndërsa nga monitorimi i faqes zyrtare fillimisht nuk rezultonte të ishte e përfshire në informacionet e publikuara, por në vijim të përditësimit të website u publikuan Rregullorja e Gjykatës Administrative të Shkalles se Pare Shkoder dhe Rregullorja për përdorimin dhe mirmbajtjen e paisjeve elektronike.

Fig. 10. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Rregullorja e gjykatës, si ishte:



³ <http://www.osce.org/sq/albania/301216?download=true>

Fig. 11. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Rregullorja e gjykatës, si është:

The screenshot shows the official website of the Administrative Court of Shkodër. The header includes the court's name in Albanian and English, along with language options (Shqip, English, Hyr) and a search bar. The navigation menu on the left lists various sections, with 'Rregullore të gjykatës' (Court Regulations) highlighted. The main content area displays a search bar for titles and a table of regulations.

Titulli	Publikuar më	Veprime
Rregullore e Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Shkodër	26-10-2017	Shkarko
Rregullore për përdorimin dhe mirmbajtjen e paisjeve elektronike	26-10-2017	Shkarko

Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, gërma c, të ligjit ku duhet të jepet informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.**

Gjykata Administrative Shkodër me anë të shkresës nr.857/1 Prot datë 27.09.2017 ka dhënë informacion rreth menyrave të depozitimit të kërkesave për informim, ndërsa në faqën e internetit të kësaj gjykatë tashme janë publikuar të dhënat për kontaktet me këtë gjykatë.

Fig. 12. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Kontaktet , si ishte:

The screenshot shows the official website of the Administrative Court of Shkodër. The header includes the court's name in Albanian and English, along with language options (Shqip, English, Hyr) and a search bar. The navigation menu on the left lists various sections, with 'Na kontaktoni' (Contact Us) highlighted. The main content area is currently empty.

Fig. 13. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Kontaktet , si është:



Referuar edhe një raporti të vitit 2015 të OSCE mbi monitorimin e gjykimeve administrative paraqitet një vështirësi përsa i përket adresave të gjykatave administrative duke qënë se ndodhen në të njëjtën godinë me gjykatat e rretheve gjyqësore dhe krijohet një konfuzion për publikun dhe një pengesë për gjyqtarët për të zhvilluar në mënyrë të qetë dhe jo të zhurmshme, të seancave gjyqësore. **Pavarësisht rekomandimit të dhënë nga OSCE situata vazhdon të mbetet e njëjtë në Gjykatën Administrative Shkodër.**

Në lidhje me percaktimet e **nenit 7, pika 1, gërma ç**, të ligjit ku *duhet të jepet informacion me të dhënat për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinitorit për të drejtën e informimit.*

Fig. 14. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Koordinatori për të drejtën e informimit, si ishte:



Fig. 15. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative, Koordinatorit për të drejtën e informimit, si është:



Në lidhje me percaktimet e **nenit 7, pika 1, gërma d**, të ligjit ku duhet të jepet informacion përsa i takon të dhënave për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime.

Për zbatimin kësaj kërkesë të ligjit pati një komunikim zyrtar me disa institucione për sigurimin e këtyre informacioneve.

Gjykata Administrative Shkodër me anë të shkresës nr.879 Prot, datë 28.09.2017, e ka përcjellë kërkesën për informacion, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë, Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në bazë të pikës 3 të nenit 12 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka dërguar kërkesën për informim në organet kompetente të lartpërmendura në lidhje me objektin e kërkesës.

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor Tiranë me anë të shkresës nr. 561/1 Prot datë 02.10.2017, në kthimin e përgjigjes, bën me dije se “Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër disponon dhe administron të gjithë informacionin e kërkuar në shkresën e protokolluar nr.760/1, datë 07.09.2017, nga Shoqata Intelektualët e rinj, Shpresë”, në lidhje me pagat e gjyqtarëve dhe nëpunësve të tjerë të Gjykatës.

Pas një ping-pong mes dy institucioneve Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor rreth informacionit që kërkohet u dërguan informacionet për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, me anë të shkresës nr 857\2 Prot, datë 25.10.2017 nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër:

Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, gërma dh**, të ligjit ku duhet të jepet informacion *mbi mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit:*

Në shkresën nr.879 Prot, datë 28.09.2017 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër shprehet se nuk disponon raporte auditimi të KLSH, duke qënë se nuk ka qënë subjekt i një kontrolli të tillë, por ka dërguar një kopje të projekt raportit të angazhimit të auditimit të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor.

Përsa i përket dokumentave që lidhen me performancën e këtij Autoriteti publik nuk na është dërguar asnjë dokument.

Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, gërma e, 7** të ligjit ku duhet të jepet *informacion për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara.*

Gjykata Administrative Shkodër në përgjigje të kërkesës për informim nr 7, datë 05. 09. 2017, të IRSH-së, ka dërguar të dhëna në lidhje me detajimin e fondit për Gjykatën Administrative Shkodër, në investime për vitin 2017, të dhëna në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore dhe me mallrat e shërbimet.

Përsa i përket vitit 2016 kemi marrë në dorëzim dokumente në lidhje me aktivin dhe pasivin e bilancit kontabël 2016 dhe gjithashtu pasqyrën e lëvizjes në CASH të vitit 2016.

Në lidhje me këtë pikë, nuk ka asnjë të dhënë të dokumentuar në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Administrative Shkodër.

Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, gërma ë**, të ligjit ku duhet të jepet informacion *mbi procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.*

Pas kërkeses nr. 8, date 06. 09. 2017, të IRSH-së, për informacion lidhur me procedurat e prokurimit publik ose procedurave konkurruese të koncensioneve dhe të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit në Gjykatën Administrative Shkodër

Në lidhje me këtë pikë Gjykata Administrative Shkodër me anë të shkresës nr.857\1 Prot, datë 27.09.2017 shprehet se komisioni për blerje të vogla është i përbërë nga tre anëtar, por nuk jepet asnjë informacion në lidhje me ta.

Në lidhje me këtë pikë, nuk ka asnjë të dhënë të dokumentuar në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative Shkodër.

Në lidhje me përcaktimet e nenit 7, pika 1, gërma f, të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, gjatë vëzhgimit të faqes së internetit të Gjykatës rezulton se ka informacion të tillë.

Sipas raportit të vitit 2015 të OSCE mbi monitorimin e gjykimeve administrative vihet re se dhënia e informacionit dhe afishimi i kalendarit të seancave bëhet në një mënyrë të parregullt dhe rekomandohet që në website të secilës gjykatë të jepet informacion i përditësuar, i saktë dhe i aksesueshëm ku përfshihet edhe kalendari javor i gjykatës. OSCE ka dalë në përfundimin se oraret e seancave gjyqësore nuk janë të afishuara ose afishohen në mënyra jo të rregullta si p.sh jo brenda afateve ligjore ose lihet lista në vende jo të dukshme për publikun ose në karriget e pritjes brenda sallave të gjyqeve. Gjykata Administrative Shkodër ka përpjekje pozitive në këtë drejtim duke përditësuar faqen e internetit me informacione të reja.

Fig. 16. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Kalendari i seancave, ishte:




Fig. 17. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Kalendari i seancave, është:




Fig. 18. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Pasqyra e shtypit, ishte:



Fig. 19. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Pasqyra e shtypit, është:



Fig. 20. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, njoftime të tjera, ishte:




Fig. 21. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, njoftime të tjera, është:

The screenshot shows the website of the Administrative Court of Shkodër. The header includes the court's name in Albanian and English, along with navigation links for 'Sistemi i drejtësisë', 'Gjykatat shqiptare', 'Statistika', 'Përshtypje', and 'Na kontaktoni'. A search bar is located in the top right corner. The main content area features a search box for titles and a table of public notices.

Titulli	Publikuar më	Veprime
Programi i Transparencës	26-10-2017	Shkarko
Deklarate	26-10-2017	Shkarko
Formulari për terheqje kopje CD audio	26-10-2017	Shkarko
Regjistri i Kërkesave dhe Pergjigjeve	26-10-2017	Shkarko
Formulari Aplikimi për Marrje dokumentash nga Arkiva e Gjykatës Adm Shkodër	26-10-2017	Shkarko
Broshure Informuese për paraqitjen e kërkesave se kopjes AUDIO	26-10-2017	Shkarko
RDA	26-10-2017	Shkarko
Per percaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore	26-10-2017	Shkarko

Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, gërma g**, të ligjit ku duhet të jepet informacion *mbi çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik.*

Nëpërmjet komunikimit zyrtar me Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë është sjelle informacion për menyrën se si bëhen kërkesat dhe ankimet pranë kësaj gjykate, me anë të shkresës nr. 955/1 Prot, datë 25. 10. 2017, kurse në faqen zyrtare të internetit nuk ka informacione të publikuara.

Në lidhje me përcaktimet e gërmës gj, pika 1 të nenit 7 të ligjit *ku duhet të jepet informacion mbi çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik; nga monitorimi rezulton të jetë publikuar në website një mekanizëm përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre, përkatësisht, në rubriken “Përshtypje”.*

Fig. 22. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Përshtypje.

The screenshot shows the 'Përshtypje' (Comments) section of the website. The header is identical to the previous screenshot. The main content area contains a form for submitting comments. The form includes fields for 'Emri Mbledhri', 'Numri i telefonit', 'Email', and 'Fax'. Below these is a text area for 'Komenti juaj max 400'. At the bottom of the form are buttons for 'Dërgo' (Send) and 'Pastro' (Clear).

Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, gërma i**, duhet të publikohet, regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;

Sipas nenit 8, pika 1 e ligjit 119\2014 Për të Drejtën e Informimit, gjithashtu është detyrim ligjore, krijimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, në të cilin parashikohet:

“Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.”

Rregjistri i kërkesave dhe përgjigjeve vazhdon të mos jetë i publikuar në faqen zyrtare të internetit.

Fig. 23. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, rregjistri i kërkesave dhe përgjigjeve;



Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, gërma, h**, të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi sistemin që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

Me shkresën nr 955/1 prot, datë 25.10.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, është kthyer një përgjigje, ku citojme: ” ...veprimtaria e Gjykatës Administrative pasqyrohet dhe ruhet në formatin ICMIS, ndërsa fizikisht gjithçka ruhet dhe dokumentohet në zyrën e arkives.”

Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, gërma, j**, të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfutuar ato; nga monitorimi rezulton se në faqen zyrtare nuk është përfshirë informacioni në lidhje me kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore, të subvencioneve si dhe procedurave për të përfutuar, gjithashtu edhe në forme shkresore nuk kemi një informacion të tillë.

Sipas nenit 7 pika 1, gërma k, të ligjit kërkohet të publikohen informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh. Në faqen online të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër nuk është bërë publik asnjë informacion i tillë, as në formë zyrtare ky informacion nuk disponohet.

Sipas nenit 7, pika 1, gërma l të ligjit kërkohet “çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik

Në faqen online të Gjykatës Administrative Shkodër janë publikuar në rubrikën “ Publikime” shpallje të ndryshme, lista ekspertësh autoteknik, ekspertësh pasurish të paluajtshme etj.

Fig. 24. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Publikime, ishte:





Fig. 25. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Publikime, është;



8.Rezultatet e Monitorimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër

8.1.Komunikimi zyrtar me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër

Për monitorimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër u procedua paralelisht nëpërmjet dergimit të kërkesave për informim dhe monitorimit të faqes zyrtare të internetit të kësaj gjykate. Iu dërguan kësaj gjykate gjithsej 14 kërkesa për informim. Për 9 kërkesat e para të dërguara për kriteret e ligjit të parashikuara në nenin 7 të ligjit nr. 119\2014, “Për të Drejtën e Informimit”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në përgjigjen zyrtare me shkresën nr 845 Prot, datë 09. 11. 2017, nuk vuri në dispozicion informacionin e kërkuar duke na referuar, sipas citimit të kësaj shkrese “...*që është informacion i cili aksesohet në faqen e internetit të Gjykatës...*”, **ndërkohe që website ishte i pa përditësuar dhe pjesa më e madhe e informacioneve nuk gjendeshin të publikuara.**

Shoqata “Intelektualet e rinj, Shprese” (IRSH), bëri ankim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për refuzim të dhënies së informacionit dhe kopje të dokumentave. Ky organ me shkresën nr. 1286\1, datë 04.10.2017, i kërkoj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër te trajtoje kërkesat për informim të dërguara nga IRSH-ja, brenda një afati të vendosur nga Komisioneri për të drejtën e informimit.


Fig.1. Shkresa nr. 1286\1, datë 04.10.2017, e Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 845Prot. të datës 11.09.2017 ku ndër të tjera thekson se: “*informacioni që kërkohet është informacion i cili aksesohet në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*” por nga verifikimi i bërë nga Zyra e Komisionerit rezulton se informacioni i kërkuar nuk gjendet në faqe.

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ankuesi kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.


Komisioneri vlerëson se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, detyrohet sipas nenit 12, 14 dhe 16 të ligjit, të informojë ankuesin lidhur me kërkesën e tij. Në rast të kundërt ky mosveprim konsiderohet kundërvajtje administrative dhe në përputhje me nenin 18/2/a/ë/g të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, “a) refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në

Fig.2. Pjese nga shkresa nr. 1286\1, datë 04.10.2017, e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, vazhdim;



Pas kësaj shkrese të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me anë të shkreses 1026 Prot, datë 17.10.2017, jo vetem që nuk vendosi në dispozicion informacionin e kërkuar nga IRSH, brenda afatit të vlerësuar nga Komisioneri, por edhe gjuha e përdorur në këtë shkresë ishte e papërshtatshme për një institucion publik.

Fig.3. Pjese e shkreses nr. 1026 datë 17.10.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër:




Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër vendosi në dispozicion vetëm një referencë ligjore pa dokumentacionin përkatës shoqërues të kërkuar. Në kundërshtim me nenin 3, pika 2 dhe 3, të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, *“Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuar nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit”*.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, trajtoj ankimin me objekt refuzimin e dhënies së informacionit dhe kopje dokumentacionit. Duke dalë me një vendim për urdhërimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër të vërë në dispozicion informacionet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar nga Komisioneri.

Vendimi mund të konsultohet në linkun e mëposhtëm: http://www.idp.al/ep-content/uploads/2017/11/Vendim_nr_96-Gjykata_e_Rrethit_Gjyqesor_Shkoder.pdf

Fig.4. Pjese nga vendimi Nr. 96, datë 08.11.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale



Në bazë të 13, pika 1, e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, *“Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë. Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, e dërgimit të tij. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas”*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nuk vuri në dispozicion informacionin për “Kopje të listes së tarifave për riprodhimin dhe dërgimin e informacionit”, as në formë shkresore dhe as në website të kësaj gjykate. Pas ankeses së IRSH-së, datë 15.12.2017, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe

Mbrojtjen e të Dhënave Përsonele, nepërmjet shkreses nr. 1570\1 Prot, datë 11.12.2017, i kërkoj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, trajtimin e kërkesës dhe vlerësimin e dhënies së informacionit të kërkuar brenda një afati të përcaktuar.

Fig.5. Pjese nga shkresa nr. 1570\1 Prot, datë 11.12.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Përsonele

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është depozituar ankesa nr. 1570 Prot., datë 05.12.2017, nga Shoqata "Intelektualët e rinj, Shpresë", përfaqësuar nga Z. Saimir Beqiraga me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", ndaj Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës së datës 01.11.2017 ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me:

1. *Kopje të listës së tarifave për riprodhimin dhe dërgimin e informacionit, (sipas detyrimit të përcaktuar për autoritetet publike në nenin 13, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit").*

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ankuesi kërkon nga KDIMDP, ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Komisioneri vlerëson se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër detyrohet sipas nenit 14 dhe 16 të ligjit, të informojë ankuesin lidhur me kërkesën e tij. Në rast të kundërt ky mosveprim konsiderohet kundërvajtje administrative dhe në përputhje me nenin 18 dhe 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Fig.6. Pjese nga shkresa nr. 1570\1 Prot, datë 11.12.2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Përsonele, Vazhdim;

Për sa më sipër, përpara marrjes së vendimit, Komisioneri kërkon të trajtoni kërkesën dhe të vlerësoni dhënien e informacionit të kërkuar brenda datës 18.12.2017. Në rast mosveprimi nga ana juaj brenda afatit të përcaktuar (datë 18.12.2017), Zyra e Komisionerit do të vlerësojë mbi ndjekjen e procedurës së mëtejshme në përputhje me nenin 18 dhe 24 të ligjit nr. 119/2014.



Pas kësaj ndërhyrjeje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dërgoj nepërmjet shkreses nr. 1300 Prot, datë 14. 12. 2017, kopje te listes së tarifave për veprime dhe shërbime që kryhen nga administrate gjyqësore, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria dhe Noteria. **Ky informacion i dërguar rezultoi se nuk i përgjigjet objektit të kërkesës sonë në bazë të nenit 13, pika 1 të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” , ku me tarifa në bazë të këtij ligji kuptohet: “Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, edhe dërgimit të tij”.**

Fig.7. Lista e tarifave për veprime dhe shërbime që kryhen nga administrate gjyqësore, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria dhe Noteria.

	Masa e tarifës në lekë	Masa e tarifës në %
A Tarifa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore e prokuroria:		
1. Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jahtë shtetit.	200	
2. Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit.	200	
3. Për lëshimin e dëshmisë së penalitetit nga zyrtar e gjepdjes gjyqësore	200	
4. Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Punëve të Jashtme	200	
5. Për lëshimin e vërtetimit se ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale nga prokuroria.	200	
6. Për lëshimin e vendimit të pushimit ose të vendimit të nesfillimit të çështjes penale nga prokuroria	200	
7. Për lëshimin e vërtetimit nga gjykata se kërkesa nuk është në proces gjyqësor.	200	
Kërkesëpadi që paraqiten në gjykatë:		
për pension ushqimor	0	
për vërtetim fakti	200	
padi për zgjidhje martesë	3000	
padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike	3000	
padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore, si dhe shkaktuar dëmi:		
I) me vlerë deri 100 000 lekë	3000	
II) me vlerë mbi 100 000 lekë		1%
padi për pjesëm pasurie	3000	
padi për këtim në punë	0	
Punimi i paligjshëm kundër vendimeve të gjykatës	200	

Nga një vëzhgim në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, konkretisht të rubrika “E Drejta e Informimit”, seksioni “Vendime”, u gjend para një vendimi të Komisionerit me pale një OJF, kundër Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt refuzimin e dhenies së informacionit dhe kopje dokumentacionit, nga kjo gjykatë.

Ky vendim gjendet në linkun e mëposhtëm: http://www.idp.al/ep-content/uploads/2017/02/Vendim_nr_24-Gjykata_e_rrethit_gjyqesor_Shkoder.pdf

Fig.8. Pjese nga vendimi nr. 24, datë 13. 02 2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Përsonele;

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës “Res Publica”, Nr. 1393 Prot., datë 05.12.2016, ndaj Autoritetit Publik/ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (shkresa nr. 144/16 Prot., nr. 145/16 Prot., nr.146/16 Prot., nr. 147/16 Prot., datë 12.10.2016), brenda datës 13. 2 .2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 13. 2 .2017.



Kjo verteton faktin që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk respekton ligjin 119\2014, Për të Drejtën e Informimit, duke refuzuar dhenien e informacioneve edhe me organizata të tjera, duke detyruar ndjekjen e procedurave pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Përsonele.

8.2. Programi i Transparencës

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër në përputhje me ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka miratuar dhe publikuar një pjesë të “Programit të Transparencës” dhe disa modele të tjera dokumentesh në website zyrtar të tyre.

Më poshtë jepet një pamje e kësaj faqeje zyrtare për ilustrim.

Fig.9. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër




Fig. 10. Faqja zyrtare e Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Programi i transparencës ishte:

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR

Kategoritë e informac	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	Urdhër Nr.1477. Date 24.02.2015 i Ministrisë të Drejtësisë "Për miratimin e strukturës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.	Pas botimit në fletoren zyrtare.	www.gjykata.gov.al në hapësirën dedikuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.	Ministria e Drejtësisë
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	1) LIGJ Nr.9877, datë 18.2.2008 PËR ORGANIZIMIN E PUSHETITIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË (Ndryshuar me ligjin nr.114/2013, datë 11.4.2013) 2) Vendim Nr. 238/1/a, datë 24.12.2008 i KLD (i ndryshuar) 3) Rregullore e Brendshme e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Urdhër i brendshëm nr 84 dt. 14/11/2011 i perditesuar me U. Brendshëm nr 39 dt. 28/06/2013 4) Urdhër i Kryetarit të Gjykatës Nr. 3 Datë 07.01.2015 për ndarjen e gjyqtareve ne seksione dhe çështjeve me short elektronik	Pas botimit në fletoren zyrtare Pas miratimit të titullarit	www.gjykata.gov.al në hapësirën dedikuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. http://www.kld.al/korniza-ligjore/akte-nenligjore	Ministria e Drejtësisë KLD Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër Koordnatori për të drejtën e informimit

Fig. 11. Faqja zyrtare e Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Programi i transparencës është:



8.3. Analiza në bazë të kritereve të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Sipas nenit 7, pika 1, germa a) të ligjit përcaktohet se: *“autoritetet publike duhet të vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit: a) një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;*

Në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk rezulton të jetë e publikuar organograma, por vetëm emrat e gjyqtarëve të kësaj gjykate dhe data e fillimit të punës së tyre në këtë gjykatë. Ajo që vihet re është se faqja nuk është rifreskuar në këtë pjesë duke pasur parasysh se disa gjyqtarë nuk janë më pjesë e kësaj gjykate.

Fig.12. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, struktura e gjykates:



Fig.13. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykatesit:

The screenshot shows the official website of the Shkodër District Court. The header includes the court's name in Albanian and English, along with a search bar and navigation menu. The main content area features a search form with fields for 'Emri' (Name), 'Nga data' (From date), and 'Deri në datën' (Until date), and a 'Kërko' (Search) button. Below the search form is a table listing judges with their names and start dates.

Emri	Data e fillimit të punës	
Valbona Durraj	04-11-2013	Shfaq çështjet
Tonin Sterkaj	30-09-2010	Shfaq çështjet
Albano Çepele	30-09-2010	Shfaq çështjet
Aleks Nikolli	30-09-2010	Shfaq çështjet
Gentian Medja	04-11-2013	Shfaq çështjet
Ermira Dedja	01-10-2010	Shfaq çështjet

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka publikuar me datë 09.10.2017 në faqen e saj zyrtare zyrtare në rubrikën “Publikime” dokumentin “Struktura dhe organika e përditësuar” ku paraqiten: numri organik dhe faktik i punonjësve, shpërndarja gjinore dhe kategorizimi i pagave për disa punonjës.

Fig.14. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër,Struktura dhe organika e përditësuar

The screenshot shows the official website of the Shkodër District Court, specifically the 'Publikime' (Publications) section. The header includes the court's name and a search bar. The main content area features a search form with a 'Titulli' (Title) field and a 'Kërko' (Search) button. Below the search form is a table listing publications with their titles, publication dates, and 'Veprime' (Actions).

Titulli	Publikuar më	Veprime
STRUKTURA DHE ORGANIKA E PERDITESUAR	09-10-2017	Shkarko
LISTA ORGANIKËS SË STAFIT NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR	09-10-2017	Shkarko
Detajimi i planit të sipas artikujve dhe elementeve perberes per fondet buxhetore per vitin 2017	09-10-2017	Shkarko
Regjistri i realizimit të prokurimit publik për 8 mujorin e vitit 2017	09-10-2017	Shkarko
UDHËZIM PËR PËRPUNIMIN DHE PUBLIKIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NË SISTEMIN GJYQËSOR	09-10-2017	Shkarko
Drejtesi pa Vonesa	09-10-2017	Shkarko
Ligji per Arkivat	09-10-2017	Shkarko
NORMA TEKNIKO-PROFESIONALE DHE METODOLOGJIKE TË SHËRBIMIT ARKIVOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	09-10-2017	Shkarko
Formular Aplikimi per Marrje dokumentash nga Arkiva e Gjykates Shkoder		Shkarko
FORMULARI PËR TË DHËNAT E KONTAKTIT		Shkarko

Fig.15. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, “Struktura dhe organika”

Nr.	Funksioni	Numri organik	Numri faktik	meshkuj	femra	Kategorizimi i pagës
1.	Kryetar	1	1	1	0	
2.	Gjyqtarë	13	12	7	5	
3.	Kancelar	1	1	1	0	
4.	Kryesekretar	1	1	1	0	III-b
5.	Sekretar gjyqësorë	15	15	0	15	IV-a
6.	Nëpunës gjyqësor	2	2	1	1	IV
7.	Kryetar i Degës së Buxhetit	1	1	1	0	III-b
8.	Specialist IT dhe i marrëdhënieve me publikum dhe mediat	1	1	1	0	IV-a
9.	Arkivist	1	1	0	1	IV-b
10.	Magaznier	1	1	0	1	V
11.	Sanitar	1	1	0	1	I
12.	Shofer	1	1	1	0	IV
13.	Mirëmbajtës	1	1	1	0	IV
14.	Punonjës sigurie	1	1	1	0	II
TOTAL		41	40			

Përsa i përket funksioneve të këtij autoriteti publik me datën 09.10.2017 është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës një listë e organikës së stafit ku përcaktohet personi dhe funksioni që ai kryen së bashku me arsimin përkatës.

Në lidhje me detyrat e këtij Autoriteti publik nuk ka ndonjë dokument të publikuar ku përcaktohen qartë këto detyra.

Fig.16. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, listë e organikës së stafit;

LISTA ORGANIKËS SË STAFIT NË GJYKATËN E RRETHIT G

N.R.	EMER	MBIEMER	Roli/Funksioni	Arsimi
1	Arben	Zefi	Kryetar	I Larte
2	Albano	Çepele	Gjyqtar	I Larte
3	Andri	Ymeri	Gjyqtar	I Larte
4	Arber	Çela	Gjyqtar	I Larte
5	Arta	Llazari	Gjyqtare	I Larte
6	Besmir	Stroka	Gjyqtar	I Larte
7	Ermira	Dedja	Gjyqtare	I Larte
8	Hasan	Selimi	Gjyqtar	I Larte
9	Irida	Kacerja	Gjyqtare	I Larte
10	Izabela	Radovani	Gjyqtare	I Larte
11	Luveda	Dardha	Gjyqtare	I Larte
12	Sokol	Shehu	Gjyqtar	I Larte
13	Tonin	Sterkaj	Gjyqtar	I Larte
14	Artan	Dragoni	Kancelar	I Larte
15	Ermal	Beqiri	K/D.B	I Larte
16	Arjeta	Plaku	K/Sekret	I Larte
17	Aleksander	Rudaj	Specialist IT	I Larte


Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, germa b**, te ligjit *ku duhet të jepet informacion për ligjet dhe aktet nënligjore në mbështetje të të cilave gjykata operon, kodit të sjelljes, rregullores së brendshme të gjykatës ose çdo dokumenti politik ose me interes publik të gjërë.*

Nga monitorimi rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka publikuar në faqen e internetit një rregullore për marrëdhëniet e gjykatës me publikun, por përsa i përket Rregullores së brendshme të kësaj gjykate dhe urdhërit të Kryetarit të Gjykatës nr.3 datë 07.01.2015 për ndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe çështjeve me short elektronik nuk disponohet asnjë material.

Fig. 17. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Rregullorja e gjykatës, si ishte:



Fig. 18. Faqja zyrtare e Gjykatës Administrative Shkodër, Rregullorja e gjykatës, si është:



Rregullorja për marrëdhëniet me publikun e publikuar nuk mjafton për të përmbushur detyrimin ligjor të kësaj gjykatë për publikimin e rregullores së brendshme të funksionimit të kësaj gjykatë.

Në lidhje me percaktimet e **nenit 7, pika 1, germa c**, te ligjit ku *duhet të jepet informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.*

Fig. 19. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Kontaktet :

The screenshot shows the official website of the Shkodër District Court. The header includes the court's name in Albanian: "GJYKATA E RRETHIT SHKODËR REPUBLIKA E SHQIPËRISË". There are language options for "Shqip", "English", and "Hyr". A search bar is also present. The main navigation menu includes "Sistemi i drejtësisë", "Gjykatat shqiptare", "Statistika", "Përshlyetje", and "Na kontaktimi". The "Na kontaktimi" section is expanded, showing contact details: "Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër", "Ruga, 'Don BOSKO' Shkodër", "Tel./FAX: +355 2224 3591", "E-Mail: Info.Gjykata.Shkoder@gjykata.gov.al", and "Njoftime.Gjykata.Shkoder@gjykata.gov.al". It also lists the working hours: "Orari i Shërbimit: e Hanë - e Premte ora: 08⁰⁰ - 16⁰⁰" and "Orari i veprimeve në kryesekretari: e Hanë - e Premte ora: 10⁰⁰ - 13⁰⁰". A sidebar menu on the left contains links for "Gjykata", "Cështjet gjyqësore", "Statistika", "Kalendari i seancave", "Informacion mbi shortin", "Lajmërime për publikun", "Publikime", "Pasqyra e shtypit", and "Rregullore të gjykatës".

Ndërsa për informacionet për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka të publikuar asnjë informacion në lidhje me këtë kërkesë të ligjit, në faqen e saj zyrtare të internetit.

Në lidhje me percaktimet e **nenit 7, pika 1, germa ç**, të ligjit ku *duhet të jepet informacion me të dhënat për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinitorit për të drejtën e informimit, nga monitorimi rezulton se një informacion i tillë është përmbushur sipas përcaktimeve ligjore, është e publikuar vendndodhja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, orari i punës dhe mënyrat e kontaktit dhe si rezultat i monitormit tonë u arrit të përcaktohej edhe koordinatori për të drejtën e informimit që mungonte me parë.*

Me anë të shkresës nr. 1026 Prot, datë 17.10.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka publikuar emrin e koordinitorit për të drejtën e informimit. Menjëherë ky informacion është publikuar edhe në faqen zyrtare të kësaj gjykate së bashku me kontaktin për këtë koordinitor.

Fig.20. Faqja zyrtare Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Koordinatori për të drejtën e informimit, ishte;



Fig.21. Faqja zyrtare Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Koordinatori për të drejtën e informimit është:



Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, germa d**, të ligjit ku duhet të jepet *informacion përsa i takon të dhënave për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;*

Janë vënë në dispozicion në faqen e internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër të dhëna përsa i përket arsimit të funksionarëve të kësaj gjykate, kategorinë e pagave për disa punonjës,

por nuk paraqiten të dhëna për pagat e funksionarëve të cilët kanë detyrimin për deklarim të pasurisë sipas ligjit dhe strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, procedurat e zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të këtij autoriteti publik, procedurat për marrjen e vendimeve.

Me datën 09.10.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka publikuar në faqen e saj zyrtare të internetit, informacion vetëm përsa i përket kategorisë së arsimit, që stafi i kësaj gjykate ka.

Fig.22. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Lista e stafit të organikës

LISTA ORGANIKËS SË STAFIT NË GJYKATËN E RRETHIT G

N.R.	EMER	MBIEMER	Roli/Funksioni	Arsimi
1	Arben	Zefi	Kryetar	I Larte
2	Albano	Çepele	Gjyqtar	I Larte
3	Andri	Ymeri	Gjyqtar	I Larte
4	Arber	Çela	Gjyqtar	I Larte
5	Arta	Llazari	Gjyqtare	I Larte
6	Besmir	Stroka	Gjyqtar	I Larte
7	Ermira	Dedja	Gjyqtare	I Larte
8	Hasan	Selimi	Gjyqtar	I Larte
9	Irida	Kacerja	Gjyqtare	I Larte
10	Izabela	Radovani	Gjyqtare	I Larte
11	Luveda	Dardha	Gjyqtare	I Larte
12	Sokol	Shehu	Gjyqtar	I Larte
13	Tonin	Sterkaj	Gjyqtar	I Larte
14	Artan	Dragoni	Kancelar	I Larte
15	Ermal	Beqiri	K/D.B	I Larte
16	Arjeta	Plaku	K/Sekret	I Larte
17	Aleksander	Rudaj	Specialist IT	I Larte

Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, germa dh**, të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit ; rezultojnë se nuk ekzistojnë të publikuara asnjë nga dokumentet e mësipërme.

Në lidhje me këtë kërkesë të ligjit nuk disponohet asnjë dokument ose e dhënë e vënë në dispozicion as në forme shkresore dhe as në website nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, germa e**, të ligjit ku duhet të jepet informacion për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifatat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara.

Në faqen zyrtare të internetit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka bërë publik me datë 09.10.2017 në rubrikën “Publikime” dokumentin me titull “Detajimi i planit sipas artikujve dhe elementëve përbërës për fondet buxhetore për vitin 2017”. Buxheti i miratuar për Gjykatën e

Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është i publikuar dhe nuk paraqiten raporte vjetore për zbatimin e buxhetit të viteve paraardhëse.

Fig.23. Faqe e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Publikime




Fig.24. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Detajimi i buxhetit në tre mujorë

Republika e Shqipërisë Gjykata Rrethit Shkoder		Shtojca 1				
Detajimi ne tre mujore, sipas artikujve dhe elementeve perberes per fondet buxhetore per vitin 2017		000/ leke				
EMERTIMI	Plani vjetor	Tremujori				
		I	II	III	IV	
1 PAGA, SHPERB, SHPEN. TJERA	42770	10800	11820	10250	9900	
Paga neto	31626	7805	8661	7630	7530	
Kompesime	0					
Tatim page	3750	1020	1020	890	820	
Sigurim shoqeror 11.2%	4174	1035	1224	985	930	
Sigurim suplementar	685	175	180	170	160	
Shperblim	0					
Ore jashte orarit gjyqtareve	1555	455	455	335	310	
Ore jashte orarit administrates	980	310	280	240	150	
2 KONTRIBUTE TE SIG. SHOQER.	6280	1530	1810	1470	1470	
Kontributi i Sig. Shoq.	6280	1530	1810	1470	1470	
Raport mjeksor, Raporte Tjera						
3 MALLRA DHE SHERB. TJERA	8350	2200	3000	1860	1290	
3.1 SHPENZIME UDHETIMI	100	20	50	20	10	
Dieta administrative	100	20	50	20	10	
Dieta per komandimet	0					
Dieta per trajnime	0					
Dieta per kolegjin zgjedhor	0					
3.2 MATERIALI E E SHERBIME ZYRE	1440	564	657	156	63	

Në lidhje me percaktimet e **nenit 7, pika 1, germa ë**, të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme:

Në faqen online të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në rubrikën “Publikime” gjendet dokumenti “Regjistër i Realizimit të prokurimeve Publike për periudhën Janar-Gusht 2017” ku paraqitet objekti i prokurimit, fondi limit, shuma e kontraktuar, lloji i procedurës së prokurimit, koha e zhvillimit të procedurës dhe palët kontraktuese, por nuk jepet informacion mbi zbatimin ose monitorimin e këtyre kontratave.

Në lidhje me anëtarët e Njësisë së Prokurimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk jep asnjë informacion në lidhje me ta.

Fig.25. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Regjistri i prokurimeve 8 mujore

Regjistri i realizimit të prokurimit publik për 8 mujorin e vitit 2017.pdf 1 / 2

Autoriteti Kontraktor GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR						
Nr	Objekti i prokurimit	Fondi Limit (pa TVSH)	Vlera e kontrates (me TVSH)	Lloji i procedurës së prokurimit	Koha e zhvillimit të procedurës	Operatori ekonomik i kontraktuar
A						
1	Ndertim					
1	Paisje elektronike	1125000				
2	Paisje elektronike (program financiar)	0				
3	Paisje mobilje	0				
4	Paisje të tjera	0				
5	Shtypshkrime	83334	41640	Prokurim me vlerë të vogël	03.05.2017	D&D GROUP Sh.p.k
6	Kancelari	166667	75600	Prokurim me vlerë të vogël	28.03.2017	Endrit Uligaj
7	Leter	166667	140000	Prokurim me vlerë të vogël	31.05.2017	InfoSoft Office Sh.p.k
8	Tonera Shtese kontrate	0	0			
9	Tonera	285000	342000	Prokurim me vlerë të vogël	08.03.2017	ADASTRA
10	Uniforma, veshje	0	0			
11	Abonime, Libra e Publikime	25000	2500	Prokurim me vlerë të vogël	18.04.2017	Njazi Uka
12	Materiale për pastrim, dezinfektim, ngrohje, ndricim	125000	60000	Prokurim me vlerë të vogël	03.05.2017	Luljeta Haderi
13	Sherbime të sigurimit dhe ruajtjes së godinave	1802500	2162457	Kerkese për propozim	02.02.2017	Miri sh.p.k
15	Shtese kontrate e vitit 2016 të sigurimit dhe ruajtjes	333334	399084	negocim pashpallje paraprak	04.01.2017	Miri sh.p.k
16	Karburant shtese kontrat	0	0			
	Karburant dhe vaj (a+b+c+d)	411667	493488	Prokurim me vlerë të vogël		
	Karburant për automjete	411667	493488	Prokurim me vlerë të vogël	15.03.2017	Kastrati sh.p.k
	Karburant për gjenerator	0	0			
	Karburant për kaldaje	0	0			
	Vaj	0	0			
17	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri (a+b+c)	83334	99168	Prokurim me vlerë të vogël		
	Pjesë këmbimi	0	0			
	Goma makine	83334	99168	Prokurim me vlerë të vogël	07.07.2017	GOMA Sh.p.k
	Bateri	0	0			
18	Siguracione të mjeteve të transportit	66667	32062	Prokurim me vlerë të vogël	21.07.2017	ALB-Siguracion _S.G.S._D.P.Sh.T.RR
19	Mirembajtje mjete transporti	332500	399000	Prokurim me vlerë të vogël	09.05.2017	Suka-Servis
20	Shpenzime të tjera transporti	0	0			
21	Mirembajtje godine	100000	16800	Prokurim me vlerë të vogël	17.03.2017	Briela sh.p.k
22	Instalim dhe shërbim interneti (lidhje pa kabllo), Fa	105000	126000	Prokurim me vlerë të vogël	07.03.2017	ABCOM sh.p.k
	Shtese kontratë instalim dhe shërbim interneti (lidhje	30000	35520	Prokurim me vlerë të vogël	06.01.2017	ABBISNET

Në lidhje me përcaktimet e nenit 7, pika 1, germa f, të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, gjatë vëzhgimit të faqes së internetit të Gjykatës rezultojnë se ka informacione të konsiderueshme në lidhje me shërbimet që ofron gjykata dhe tarifat e këtyre shërbimeve, gjithashtu gjenden edhe disa formularë për t'u plotësuar për të marrë shërbimet që ofrohen. Gjithashtu edhe me anë të shkresës nr.1069 datë 27.10.2017 ka renditur shërbimet që ky Autoriteti Publik ofron.

Megjithatë vihet re, në faqen zyrtare të internetit të kësaj gjykate, një shpërndarje e këtyre informacioneve, në rubrika të ndryshme dhe pa një emërtim të qartë, gjë që veshtirëson kërkimin e këtyre informacioneve nga publiku i interesuar.

Fig. 26. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Publikime

GJKATA E RRETHIT SHKODËR
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Sistemi i drejtësisë Gjykatat shqiptare Statistika Përshtypje Na kontakttoni

Gjykata
Cështjet gjyqësore
Statistika
Kalendari i seancave
Informacion mbi shortin
Lajmërime për publikun
Publikime
Pasqyra e shtypit
Rregullore të gjykatës
Programi i transparencës
Adresa të tjera të dobishme
Përshtypje

Titulli Kërko

Titulli	Publikuar më	Veprime
Formulari Aplikimi për Marrje dokumentash nga Arkiva e Gjykatës Shkoder		Shkarko
FORMULARI PËR TË DHËNAT E KONTAKTIT		Shkarko
Formulari për terheqje kopje CD audio		Shkarko
Programi i Transparencës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër		Shkarko
Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve		Shkarko
TARIFA GJYQËSORE		Shkarko

Fig. 27.28. Faqja zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Pasqyra e shtypit;

GJKATA E RRETHIT SHKODËR
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Sistemi i drejtësisë Gjykatat shqiptare Statistika Përshtypje Na kontakttoni

Gjykata
Cështjet gjyqësore
Statistika
Kalendari i seancave
Informacion mbi shortin
Lajmërime për publikun
Publikime
Pasqyra e shtypit
Rregullore të gjykatës
Programi i transparencës
Adresa të tjera të dobishme
Përshtypje
Na kontakttoni
Multimedia

Titulli Kërko

Titulli	Publikuar më	Veprime
Broshure Informuese për paraqitjen e kërkesës së kopjes AUDIO		Shkarko
Fletpalosje RDA		Shkarko
Formulari Aplikimi për Marrje dokumentash nga Arkiva e Gjykatës Shkoder		Shkarko
FORMULARI PËR TË DHËNAT E KONTAKTIT		Shkarko
Formulari për terheqje kopje CD audio		Shkarko
LISTA E EKSPERTEVE 2016 - INSTITUTI I MJEKESISE LIGJORE		Shkarko
LISTA E EKSPERTEVE 2016 - INSTITUTI PËR KËRKIMET DHE ANALIZË TË AKSIDENTEVE RRUGORE		Shkarko
LISTA E EKSPERTEVE 2016 - Lista e Ekspertëve Autoteknike dhe Vlerësuesve të Demeve Materiale dhe Shendetesore		Shkarko
LISTA E EKSPERTEVE PËR MBIKQYRJË DHE KOLAUDIM NË NDERTIM		Shkarko
LISTA E PËRKTHYESVE TË AUTORIZUAR PËR PËRKTHIM ZYRTAR PËR - 2016		Shkarko

GJKATA E RRETHIT SHKODËR
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Sistemi i drejtësisë Gjykatat shqiptare Statistika Përshtypje Na kontakttoni

Gjykata
Cështjet gjyqësore
Statistika
Kalendari i seancave
Informacion mbi shortin
Lajmërime për publikun
Publikime
Pasqyra e shtypit
Rregullore të gjykatës
Programi i transparencës
Adresa të tjera të dobishme
Përshtypje
Na kontakttoni
Multimedia

Titulli Kërko

Titulli	Publikuar më	Veprime
Programi i Transparencës Gj. Rr. Gj. Shkoder		Shkarko
Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve		Shkarko
Regjistri i Ndermjetesve		Shkarko
Regjistri i përgjigjeve për kërkesat dhe Vendimet		Shkarko
REGJISTRI I PERMBARUESVE GJYQËSORE PRIVATE AKTIVE		Shkarko
TARIFA GJYQËSORE		Shkarko
test		Përshtypje
UDHËZIM I PËRBASHKËTËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE		Shkarko


Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, germa g**, të ligjit ku *duhet të jepet informacion mbi çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka vënë në dispozicion një informacion te tillë, gjithashtu ky informacion nuk gjendet as në faqen online të kësaj gjykate.

Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, germa gj**, të ligjit ku *duhet të jepet informacion mbi çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik.*

Në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në rubrikën “Përshtypje” ka një hapësirë ku qytetarët mund të shprehin komentet e tyre në lidhje me gjykatën.

Fig. 29. Faqja Zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Përshtypje;



The screenshot shows the website of the Shkodër District Court. The header includes the court's name and logo. The main content area features a form for submitting comments, with fields for name, phone number, email, and fax, and a large text area for the comment itself. A 'Dërgo' (Send) button is visible at the bottom of the form.

Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, germa h**, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;

Me anë të shkresës nr.1071 Prot datë 27.10.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka evidentuar sistemin që përdor ky Autoritet Publik për të ruajtur dokumentet, nga e cila citohet: “ ... iu bëjmë me dije se nga ana e gjykatës operohet me sistemin ICMIS, në të cilin rregjistrohen dhe pasqyrohen të gjitha çeshtjet që paraqiten qofshin këto kërkesa apo kërkesë padi, si për çeshtje civile, si dhe për çeshtje penale, që paraqiten me kërkesë të prokurorisë.... ”


Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, germa i**, të ligjit ku *duhet të jepet informacion mbi regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji*;

Sipas nenit 8, pika 1 e ligjit 119\2014 Për të Drejtën e Informimit, gjithashtu është detyrim ligjore, krijimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, në të cilin parashikohet:

“Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka të publikuar në faqen zyrtare të internetit regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve.

Fig.30. Faqja Zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Regjisti i kërkesave dhe përgjigjeve;



Nga monitorimi rezulton se paraqitet një tabelë e paplotësuar e një faqeje të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të Qershorit të vitit 2016 në rubrikën “Njoftime të tjera” në website;

Fig. 31. Faqja Zyrtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Njoftime të tjera, Regjistri i pergjigjeve për kerkesat dhe vendimet;

Regjistri i pergjigjeve për kerkesat dhe Vendimet				Qershor 2016			
Nr. R.	Data e regjistrimit të kerkesës	Objekti	Data e kthimit të pergjigjes	Statusi i kerkesës			Tarifa
				K/Sekretaris	Kancelari	Arkiva	
1	/_/2016		/_/2016				
2	/_/2016		/_/2016				
3	/_/2016		/_/2016				
4	/_/2016		/_/2016				
5	/_/2016		/_/2016				
6	/_/2016		/_/2016				
7	/_/2016		/_/2016				
8	/_/2016		/_/2016				
9	/_/2016		/_/2016				
10	/_/2016		/_/2016				

Në lidhje me përcaktimet e **nenit 7, pika 1, germa j**, të ligjit ku duhet të jepet informacion mbi kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato; nga monitorimi rezulton se në faqen zyrtare nuk është përfshirë informacioni në lidhje me format e ndihmës shoqërore, subvencioneve si dhe procedurave për të përfituar.

Me anë të shkresës nr.1069 Prot datë 27.10.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka evidentuar në mënyrë të përgjithshme kategoritë e personave që përjashtohen nga taksat gjyqësore, ndërsa përsa i përket procedurave për të përfituar nga këto ndihma nuk jepet informacion.

Sipas **nenit 7 pika 1, germa k**, të ligjit kërkohet të publikohen informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh. Në faqen online të Gjykatës nuk është bërë publik asnjë informacion i tillë, as nga komunikimet zyrtare një informacion i tillë nuk disponohet.

Sipas **nenit 7, pika 1, germa l** të ligjit kërkohet “çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik

Në faqen online të Gjykatës Administrative Shkodër janë publikuar në rubrikën “Publikime” shpallje të ndryshme, lista ekspertësh autoteknik, ekspertësh pasurish të paluejtshme etj.

Shënim: Ky raport përpara prezantimit të tij i është dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe Administrative të Shkallës së parë duke i kërkuar dhënien e komenteve në lidhje me gjetjet e raportit dhe duke caktuar si afat përfundimtarë ligjor për dërgimin e komenteve datën 15 Maj 2018. Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ka patur asnjë përgjigje dhe nuk është dërguar asnjë koment çka tregon se gjetjet e raportit të mbështetura me referenca ligjore dhe fakte kanë qene me vend dhe janë pranuar të gjitha ndërsa nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë janë dërguar komentet si mëposhtë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
SHKODËR

(Adresa: L. QemalStafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22)

Nr. 520/4 Prot

Shkodër, me 15.05.2018

Lënda : Mbi raportin e transparencës në gjykata.

Drejtuar : Presidentit të Shoqatës "Intelektualët e rinj shpresë"
Z. Saimir Beqiraga
Adresa: L. "Qemal Stafa" Rr. "Daut Boriçi" Nr. 874

SHKODER

I Nderuar Z. Beqiraga!

Pas njohjes me raportin e transparencës në gjykata, si përmbledhëse e punës së organizatës tuaj, duke respektuar dhe mbështetur iniciativën dhe horizontin e brezit të ri në perceptimin dhe konturimin e funksionimit të institucioneve shtetërore në kuadër të evidentimit të transparencës së veprimtarisë së tyre, dua të ndalem në një moment të hulumtimit tuaj.

Nuk e gjejmë me vend shprehjen "presion institucional" në bërjen funksionale të faqes zyrtare të gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, pasi një mangësi e tillë doli qartë që nuk vinte për neglizhencë apo mosdëshirë nga ana e Gjykatës Administrative për mosfunksionim, por vinte për shkaqe që nuk kishin të bënin me veprimet e Gjykatës. Këtë e faktoi më së miri fakti që, pasi i dhanë akses gjykatës në kryerjen e veprimeve (teknike) me faqen, ajo u bë lehtësisht e vizitueshme për publikun, duke u plotësuar dhe azhornuar (çdo ditë) në rubrikat që ajo përmban, në kuadër të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Në këtë këndvështrim, do të ishte gjetja e një shprehjeje më të saktë dhe në kuadër të frymës së bashkëpunimit.

Po kështu, sa i takon azhornimit të faqes zyrtare të gjykatës, ajo azhornohet çdo ditë në rubrikat e saj, ku më kryesorja është ajo e të dhënave mbi çështjet gjyqësore administrative të regjistruara (datë depozitimi, palët ndërgjyqëse, objekti, datë shortimi, gjyqtari i çështjes, process-verbale, vendimi i çështjes, etj.), por jo vetëm, azhornime edhe në lidhje me njoftime të ndryshme sidomos lidhur me çështjet në gjykim, sic janë shpalljet për palët me të cilat nuk arrihet të realizohet njoftimi sipas normave procedurale në fuqi. Ashtu sikurse, faqja zyrtare përmban link-et e institucioneve të ndryshme në të

56

cilat qytetarët e interesuar mund të drejtohen për të marrë informacion për interesat e ndryshme që mund të shprehin por që nuk mbulohen nga veprimtaria e gjykatës administrative, apo mbi kërkesat dhe përgjigjet që u jepen personave që i drejtohen gjykatës, për të cilat natyrisht respektohet afati ligjor dhe janë azhornuar në faqen zyrtare të gjykatës.

Pra, do të ishte në të mirën e të gjitha palëve, si të organizatës suaj si hulumtuese dhe mbikëqyrëse në procese të tilla, por edhe të institucioneve që ju merrni në vëzhgim (rasti konkret për Gjykatën Administrative Shkalla Parë Shkodër), që të pasqyrohej më saktësisht dëshira, vullneti dhe kapaciteti i rolit të sejcilit aktor (cilido qoftë) në këto procese.

